Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1009

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje tëVjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Wood Company" Sh.P.K. të datës 13.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Pejës të datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lënd djegëse - Dru dhe Pelet - LOT 2- Furnizim me lëndë djegëse - Pelet" me numër të prokurimit635-23-8135-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë12.01.2024merr këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Wood Company" Sh.P.K. me nr. 2023/1009 e datës 13.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues - Komuna e Pejës të datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lënd djegëse - Dru dhe Pelet - LOT 2- Furnizim me lëndë djegëse - Pelet" për LOT2 me numër të prokurimit635-23-8135-1-1-1.

2. VërtetohetNjoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Pejës të datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohetkonfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Pejësnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 02.08.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lënd djegëse - Dru dhe Pelet - LOT 2- Furnizim me lëndë djegëse - Pelet" me numër të prokurimit 635-23-8135-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 340,000.00€.

Me datë 29.11.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik "Petrol Company Sh.P.K. & Bek Fluids L.L.C". Me datë 04.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 06.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues. Me datë 13.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1009.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, përkatësisht kërkesën 1 për LOT-2 ku operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës së ngjashme në vlerë prej 150.000.00 Euro në tri (3) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Si dëshmi dokumentare është kërkuar një listë e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën

e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues në vendimin e datës 06.12.2023 i ka refuzuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit si te pabazuara në fakte dhe prova konkrete, duke pohuar shkurtimisht se sipas vendimit parapk AK e kishte kthyer lenden ne Rivlersim dhe gjate procedurës së rivlerësimit konform vendimit kishin dërguar letër sqarime shtes tek OE per furnizimet e bëra me pelet respektivisht lidhur me kontratën e nënshkruar mes kompanisë GOE Petrol Company SHPK dhe DHF Company SHPK sipas nenit 72 të LPP kurse OE me datën 22.11.2023 ka kthyer përgjgije duke dërguar të gjitha dokumentet relevante të kërkuara me anë të së cilave ka dëshmuar për AK duke sjelluar kontratë e nënshkruar ndërmjet palëve, faturat, transaksione bankare në të cilat ceket qart se OE ka bërë furnizim me pelet me kompanin DHF, andaj bazuar në provat e sigurar është vërtetuar se OE e ka plotësuar në tërësi kërkesat e DT, kurse ne si inicuese e këtij aktiviteti të prokurimit nga cilësia jonë si AK kemi vepruar konform LPP dhe kemi vazhduar me OE me çmimin e ofertës më të lirë i cili ka rezultuar te jetë edhe i përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit. Kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues që ankesa e OE të refuzohet si e pabazuar kurse të vërtetohet vendimi i AK për dhënie të kontratës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18.12.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 21.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues*".

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "përmes raportit me nr. 798/23 të datës 09.11.2023 është rekomanduar AK që me rastin e rivlerësimit të kërkoj sqarimeve nga tani tenderuesi i rekomanduar (atëher OE ankues). Bazuar ne shkresat e lëndës AK ka kërkuar sqarime me datë 17.11.2023, kurse OE tani i rekomanduar për kontratë ka ofruar si sqarime si kontratën për furnizim me derivate të naftës dhe peletit e lidhur me datë 11.05.2019 në mes të Petrol Company Sh.p.k. dhe DHF Company Sh.p.k. Më këtë kontratë ka bashkangjitur ekstraktin bankar nga banka NLB për periudhën 01.01.2023 - 30.05.2023, pastaj ka bashkangjitur faturat me numër 399/23 e datës 03.02.2023 në vlerë 17,000.00 euro, fatura nr. 405/23 e datës 10.02.2023 në vlerë 22,700.00 euro, fatura nr. 462/23 e datës 24.02.2023 në vlerë 21,600.00 euro, fatura nr. 501/23 e datës 01.03.2023 në vlerë

21,100.00 euro, fatura nr. 621/23 e datës 03.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, fatura nr. 642/23 e datës 08.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, fatura nr. 649/23 e datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro, fatura nr. 689/23 e datës 17.03.2023 në vlerë 21,000.00 euro dhe faturën numër 698/23 e datës 23.03.2023 në vlerë 21,500.00. Pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve të dorëzuara nga OE Petrol Company, ekspertja shqyrtuese vlerëson se duke pasur parasysh kontratën e lidhur në mes të Petrol Company Sh.p.k. dhe DHF Company Sh.p.k., faturat e lëshuara nga Petrol Company në cilësi të shitësit dhe DHF Company në cilësi të blerësit të cilat përputhen me natyrën e kontratës si dhe shqyrtimin e ekstraktit bankar, ekspertja shqyrtuese vlerëson se këto fatura përputhen me pagesat të cilat ishin kryer përmes llogarisë bankare. Më konkretisht, pagesa me numër të urdhrit 71, datë 08.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro përputhet me vlerën e faturës me numër 642/23 të datës 08.03.2023, pagesa me numër të urdhrit 64 të datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro përputhet me faturën numër 649/23 të datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro, pagesa në vlerë 21,000.00 euro sipas numrit të urdhëresës 62 të datës 17.03.2023 përputhet me faturën me numër 689/23 të datës 17.03.2023 në vlerë 21,000.00 euro, pagesa në vlerë 21,600.00 euro sipas numrit të urdhëresës 86 të datës 24.02.2023 përputhet me faturën numër 462/23 të datës 24.02.2023 në vlerë 21,600.00 euro, po ashtu pagesa në vlerë 23,000.00 euro sipas urdhëresës numër 77 të datës 03.03.2023 përputhet me faturën numër 621/23 e datës 03.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, etj. Andaj, ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në kontratën e dorëzuar, faturat e dorëzuara dhe qarkullimin për periudhën 01.01.2023-30.05.2023, konsideron se këto të dhëna përputhen dhe tejkalojnë vlerën e kërkuar nga AK. Sa i përket pikës ankimore të OE ankues se kjo kontratë mundet me qenë fiktive për shkak se më herët çmimi i peletit për një ton ka qenë 500 euro, ndërsa faturat e lëshuara janë me çmim prej 250 euro për një ton pelet, ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë të dokumenteve të dorëzuara në e-prokurim, vlerat e faturave përputhen me vlerat e pagesave në ekstraktin bankar, kurse sa i përket çështjes sa ka qenë çmimi për një ton pelet atëherë dhe në kohën kur janë lëshuar këto fatura, nuk është në kompetencë as të ekspertes as të ndonjë pale tjetër që të shqyrtoj dhe analizoj afarizmin e një biznesi. Në rast se OE ankues konsideron se është dorëzuar ndonjë dokument i falsifikuar apo dokument fiktiv siç e quan OE ankues, përveç që do duhej që ta dërgonte te organet kompetente, ka edhe obligim ligjor që të lajmëroj veprën penale te organet kompetente në rast se mund të argumentoj se çfarë është falsifikuar. Andaj, bazuar në sqarimet e lartpërmendura ekspertja shqyrtuese vlerëson se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nga ana e AK është bere konform nenit 59 të LPP".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues fillimisht potencon se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohen pretendimet ankimore është se operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës së ngjashme në vlerë prej 150.000.00 Euro në tri (3) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Në këtë drejtim, Paneli Shqyrtues ka gjetur se gjatë rivlerësimi, AK kishte kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar i cili në emër të sqarimeve ka dërguar kontratën për furnizim me derivate të naftës dhe peletit e lidhur me datë 11.05.2019 në mes të Petrol Company Sh.p.k. dhe DHF Company Sh.p.k. Më këtë kontratë ka bashkangjitur ekstraktin bankar nga banka NLB për periudhën 01.01.2023 - 30.05.2023, pastaj ka bashkangjitur faturat me numër 399/23 e datës 03.02.2023 në vlerë 17,000.00 euro, fatura nr. 405/23 e datës 10.02.2023 në vlerë 22,700.00 euro, fatura nr. 462/23 e datës 24.02.2023 në vlerë 21,600.00 euro, fatura nr. 501/23 e datës 01.03.2023 në vlerë 21,100.00 euro, fatura nr. 621/23 e datës 03.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, fatura nr. 642/23 e datës 08.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, fatura nr. 649/23 e datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro, fatura nr. 689/23 e datës 17.03.2023 në vlerë 21,000.00 euro dhe faturën numër 698/23 e datës 23.03.2023 në vlerë 21,500.00. Paneli Shqyrtues konsideron se ekspertja shqyrtuese ka analizuar dhe trajtuar me kujdes këto dokumente ashtu që ka konstatuar me të drejtë se faturat e lëshuara nga Petrol Company në cilësi të shitësit dhe DHF Company në cilësi të blerësit përputhen me pagesat të cilat ishin kryer përmes llogarisë bankare. Më konkretisht, pagesa me numër të urdhrit 71, datë 08.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro përputhet me vlerën e faturës me numër 642/23 të datës 08.03.2023, pagesa me numër të urdhrit 64 të datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro përputhet me faturën numër 649/23 të datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro, pagesa në vlerë 21,000.00 euro sipas numrit të urdhëresës 62 të datës 17.03.2023 përputhet me faturën me numër 689/23 të datës 17.03.2023 në vlerë 21,000.00 euro, pagesa në vlerë 21,600.00 euro sipas numrit të urdhëresës 86 të datës 24.02.2023 përputhet me faturën numër 462/23 të datës 24.02.2023 në vlerë 21,600.00 euro, po ashtu pagesa në vlerë 23,000.00

euro sipas urdhëresës numër 77 të datës 03.03.2023 përputhet me faturën numër 621/23 e datës 03.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, etj. Duke marrë parasysh se tenderuesi i rekomanduar ka dëshmuar si më sipër që e përmbush në tërësi kërkesën e dosjes së tenderit të kontestuar nga operatori ekonomik ankues, Paneli Shqyrtues bazuar ne provat e administruara përfshirë raportin e ekspertit shqyrtues ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Pasi që edhe ekspertja shqyrtuese ka arritur deri te përfundimet e njëjta.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit nga ana tjetër paneli vlerëson se kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjith ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"* kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme, sepse apriori sipas dokumenteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar i njëjti ka plotësuar kërkesat e vendosura nga AK dhe është ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Pejës të datës 29.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lënd djegëse - Dru dhe Pelet - LOT 2- Furnizim me lëndë djegëse - Pelet" me numër të prokurimit 635-23-8135-1-1-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues në këtë vendimmarrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **" WOOD COMPANY " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: